



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CA.nr.2214/2017

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu kryesues, Kujtim Pasuli e Zenel Leku - anëtarë, (më tej kolegji) në çështjen juridike të paditësve: L.S. dhe M.S., të dy nga Gjilani, Lagja "... të përfaqësuar nga SH.XH., av. në Gjilan, kundër të paditurve: J.S., me adresë të njejt të vendbanimit,(me paditësit) i përfaqësuar nga M.S., av. në Gjilan, A.S., nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, për vërtetimin e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë në patundshmëri, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.556/2015 të datës 20.02.2017, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 07.12.2020, jep:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e paditësve L.S. dhe M.S., e paraqitur nga përfaqësuesi i tyre av. SH.XH., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.556/2015 i datës 20.02.2017 **Vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin C.nr.556/2015 të datës 20.02.2017, ka vendosur si vijon:

“ Refuzohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve L.S. dhe M.S., nga Gjilani, me të cilën kanë kërkuar që te ju njihet e drejta e pjesës së domosdoshme në ngas. Kadastrale P- ..., ne sipërfaqe prej 632m2 ZK Gjilan, dhe të obligohet i padituri J.S., që këtë të drejtë t’ia

njohë paditësve në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Shfuqizohet masa e përkohshme e sigurimit e caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr556/2015, e dt. 23.10.2015.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale”.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i paditësve av. SH.XH., me dt. 27.04.2017, ka paraqitur një ankesë me të cilën ka kërkuar që aktgjykimi ankimor të ndryshohet, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, ose i njëjti të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

Përgjigje në ankesë është paraqitur.

Kompetenca: Gjykata e Apelit, ka juridiksion për procedim në shkallë të dytë të kësaj çështje ankimore, në bazë të neneve: 22 e 23 të Ligjit për gjykatat nr.06/L-054 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 22 e dt. 18. Dhjetorë 2018).

Vlerësimi formal i ankesës: Sipas shkresave në dosje rezulton se ankesa përmbushë kërkesat ligjore për procedim, nga nenet 176, 178, 181 të LPK, pasi që ajo është paraqitur brenda afatit ligjor, është e lejueshme, i përmban elementet e nevojshme për procedim dhe është paraqitur për shkaqet e parapara me ligj.

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjyimit të shkallës së parë: Gjykata e shkallës së dytë e ekzaminoi aktgjykimin ankimor në bazë të nenit 194 të LPK-së, brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, si dhe, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

Ankesa është e pa themeltë.

Kolegji, konstaton se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore si dhe me rastin e dhënies së aktgjykimit ankimor nuk ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2, b), g), j), k) dhe m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit, në procedurë sipas ankesës, kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje tjera procedurale që do të ishin me ndikim në vendimmarrje të ligjshme dhe të drejtë në këtë çështje juridike.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi L.S., me dt.23.09.2015, kishte paraqitur një padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurve: J.S. dhe A.S., me kërkesë për vërtetimin e të drejtës në pjesën e domosdoshme të trashëgimisë në ngastrën kadastrale P-... në sipërfaqe pre 632m2 ZK Gjilan, dhe të detyrohet i padituri J.S., që paditësit t'ia njoh këtë të drejtë.

Përfaqësuesi i paditësit av. SH.XH., me parashtrësën e dt.21.10.2015, në cilësi të paditësit kishte përfshirë edhe M.S.n, vëllai i paditësit L.S., përkatësisht djali i të paditurit të parë J.S..

Paditësit në padi kanë pohuar se, babai i tyre i padituri i parë J.S., dëshiron të shesë shtëpinë dhe oborrin në ngastrën kadastrale të cekur në kërkesëpadi edhe pse nuk ka kurrfarë arsye.

Në të njëjtën shtëpi jeton paditësi me familjen e tij, motra e tij F.S. si dhe vëllai F.S.1.

Gjykata e shkallës së parë, kishte bërë shqyrtimin kryesor të çështjes, kishte marrë provat e përshkruara në procesverbalin e seancës përkatëse, dhe kishte konstatuar gjendjen faktike, të përmbajtur në arsyetimin e aktgjykimit ankimor si vijon: Nga provat e administruara, por edhe nga pohimi i palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti se i padituri i parë J.S., babai i paditësve e kishte blerë patundshmërinë tani kontestuese nga i padituri i dytë A.S., nga fsh. ... para 40 vitesh, me anë të kontratës gojore. Kontratën gojore, tani të paditurit e kishin legalizuar të noteri A.M., sipas nr. LRPnr.2004/14, me dt.28.04.2014.

Nuk ishte kontestuese se në këtë paluajtshmëri gjatë kësaj kohe ishte ndërtuar shtëpia 3 katesh, në të cilën tani në katin e parë të shtëpisë jeton paditësi i dytë me familjen e tij dhe motrën e pa martuar, ndërsa në katin e dytë jeton i padituri i parë- babai i paditësve se bashku me bashkëshorten e tij (njerkën e paditësve), por kontestues në mesë të palëve ishte se paditësit kishin dëgjuar se babai i tyre e kishte lidhur kontratën mbi shitblerjen me të paditurin e dytë A.S., e që në këtë kohë paditësi i dytë gjendej azil me familjen e tij në Gjermani, ashtu që paditësi i parë kishte dyshuar se babai i tyre tani i padituri mund ta tjetërsoj këtë paluajtshmëri.

Nga provat e administruara gjykatës i rezultojë se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me Ligjin mbi trashëgimin e Kosovës, neni 30 dhe 31, për ta vërtetuar se paditësit kanë të drejtë mbi vërtetimin e pjesës së domosdoshme të pasurisë ashtu siç është cekur në pikën I. të dispozitivit, pasi që i padituri J.S., babai i paditësve, është vetë në jetë dhe ka të drejtën të disponoj vet me pasurinë e tij edhe me ngastrën tani kontestuese dhe meqë djemtë e tij jetojnë në shtëpinë e përbashkët edhe për kundër faktit se i ka vdekur bashkëshortja e parë (nëna e paditësve) nuk ka tentuar e as nuk tentoj t'i largoj fëmijët e tij nga shtëpia fakt te cilin gjykata e vërtetoj nga deklarata e të paditurit të dhënë nën betim në cilësi të palës.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat e tjera materiale dhe ka shqyrtuar pretendimet e paditësve (gojore dhe atyre me shkrim) por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritorë të kësaj çështje juridike kontestimore.

Gjykata vendosi si në pikën nën II te dispozitivit të aktgjykimit, më saktësisht e shfuqizoi masën e përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.556/15 të dt.28.09.2015, pasi erdhi në përfundim se kanë pushuar së ekzistuari kushtet dhe rrethanat për të cilat gjykata e ka caktuar këtë masë dhe më nuk ka ndonjë rrezik që paditësit të pësojnë ndonjë dëme të pariparueshëm.

Paditësit me asnjë provë nuk kanë arritur ta bindin gjykatën dhe t'i bëjnë të besueshme pretendimet e tyre se i padituri i parë kishte qellim t'i largoj nga shtëpia apo ta shes dhe tjetërsoj shtëpinë.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të çështjes gjykata e shkallës së parë, kishte vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, duke vlerësuar se janë përmbushur kërkesat ligjore nga par.2 i nenit 143 i LPK.

Pretendimet ankimore: Përfaqësuesi i paditësve, av. SH.XH., në ankesë ka pohuar se aktgjykimi ankimor, është përfshirë më shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 n) i LPK , e cila konsiston në faktin se dispozitivi i aktgjykimit ankimor është kontradiktor me vet vetën dhe me arsyetimin e tij.

Arsyetimi nuk përmban arsyet për faktet vendimtare.

Pra gjykata e shkallës së parë, i ka marrë parasysh vetëm faktet në favor të paditurit J.S., pa dhënë arsye për faktet e prezantuara nga ana e paditësve.

Nuk janë kontestuese faktet se i padituri J.S., është babai i paditësve, i cili pos paditësve i ka edhe 5 fëmije të tjerë.

Po ashtu nuk është kontestues se paditësve ju ka vdekur nëna, e cila ishte bashkëshorte e të paditurit J.S..

Vetëm këto fakte flasin mjaftë se paditësit dhe vëllezërit e motrat tjera të tyre kanë të drejtë në pjesën e domosdoshme kundër të paditurit, përkatësisht babait të tyre.

Gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale sipas bazës ligjore të neneve 30 dhe 31, të Ligjit mbi trashëgiminë, sepse paditësit kanë të drejtë në vërtetimin e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë.

Sipas bazës ligjore të nenit 31.1 të LTK, trashëgimlënësi nuk mund të disponoj në pjesën e domosdoshme të trashëgimisë, që u takon trashëgimtarëve.

Vetë fakti se i padituri J.S., babai i paditësve, është martuar me grua tjetër, flet se i padituri ka pretendime që ta shes atë pasuri që të pavarësohet nga fëmijët e tij dhe me ato të holla të krijoj kushte për jetesë vetëm për vete dhe bashkëshorten e tij.

Shfuqizimi i vendimit për masën e sigurisë para se aktgjykimi në këtë kontest të bëhet i formës së prerë, është i pa drejtë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, të shprehur në aktgjykimin ankimor, kolegji e vlerëson të bazuar në ligj dhe të drejtë, sepse ai është rezultat i konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, në të cilën drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Paditësit deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë e as në procedurë sipas ankesës, nuk provuan se i padituri J.S., (babai i paditësve) me ndonjë veprim juridik, qoftë me testament, me pjesëtim të pasurisë apo me kontratë për mbajtjen e përrjetshme, i ka përjashtuar paditësit si trashëgimtar të domosdoshëm, nga e drejta në pjesën e domosdoshme të trashëgimisë.

Faktet se i padituri J.S., babai i paditësve, pas vdekjes së nënës së paditësve, është martuar me një grua tjetër dhe jeton në të njëjtën pronë objekt kontesti me paditësit, dhe se kontratën gojore mbi shitblerjen e truallit, nga ish pronari, e ka legalizuar të noteri, nuk përbëjnë veprime juridike e as faktike me të cilat i padituri i përjashton paditësit si trashëgimtarë të domosdoshëm nga e drejta e tyre, e pretenduar.

Paditësit në këtë rast edhe për kundër faktit se e kishin barrën e provës nuk provuan asnjë fakt relevant në masën e duhur, se i padituri ka ndërmarrë ndonjë veprim juridik, apo faktik për cenimin e të drejtës së tyre në pjesën e pretenduar, në patundshmërinë objekt kontesti.

E drejta e pretenduar në pjesën e domosdoshme të trashëgimisë, nuk mund të përcaktohet dhe realizohet sa është gjallë pronari i patundshmërisë përkatëse.

Trashëgimtarët e domosdoshëm, të drejtën e pronësisë në pjesën e domosdoshme, në bazë të trashëgimisë, nën kushtet e parapara me Ligjin për trashëgiminë.

Andaj kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të paditësve në këtë rast ishin të pa themelta dhe si të tilla u refuzuan.

Me sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë përmbushur kërkesat ligjore nga neni 200 i LPK, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË

CA. nr.2214/17 dt. 07.12.2020

Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari,

Gani Avdiu